



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:200556

Datë: 02.09.2024

Numri i dokumentit: 06112892

C.nr.3390/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarin Taulant Rexhëbeqaj, në çështje juridike kontestimore të paditësit: A.B. nga fshati Komuna e Rahovecit, me numër personal të cilin me autorizim e përfaqëson Av. D.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: kompensim dëmi, jashtë seance, më datë 02.09.2024, mori këtë :

A K T G J Y K I M

-Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia-

REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit A.B. nga fshati Komuna e Rahovecit, me të cilën ka kërkuar që të “ *Aprovohet padia dhe kërkesë padia e paditësit A.B. nga fshati Komuna e Rahovecit, në tërësi si e bazuar obligohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli në Prishtinë - që paditësit A.B. t’ia kompensojë dëmin jo material –lëndimeve të lehta trupore paditësit A.B. shumat si në vijim: Në emër të dhimbjeve fizike1500 €; Në emër të frikës së përjetuar.....1000 €; Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj për çdo muaj....200 €; Në emër të ushqimit të përforcuar për çdo muaj..... 200 €; Në emër të rehabilitimit fiziko –terapeutik...200 €, me kamat ligjore prej 8%, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm, obligohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli në Prishtinë që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim ”. **si e pabazuar.***

A r s y e t i m

Paditësi A.B. nga fshati Komuna e Rahovecit, përmes të autorizuarit të tij, av. D.M. nga Prizreni, me datën 29.09.2024, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli në Prishtinë, duke theksuar se me datë 18.09.2022, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, ku deri te aksidenti ka ardhur kur vozitësi i automjetit A, “Citroen DS3”, ngjyrë e kuqe, me targa, ishte duke lëvizur në rrugën Prizren-Gjakovë, me të arritur në fshatin Landovicë, përball ish kafeterisë “Syri”, në mënyrë të pasigurt merr veprim që me kthim majtas të qyqet nga rruga kryesore në drejtim të parkingut të kafeterisë “Syri”, me distancë të shkurtër i del përpara automjetit B, të tipit “Ford Ka”, me targa të regjistrimit: ngjyrë e zezë, viti i prodhimit: 2000.

Gjykata me aktvendimin C.nr.3390/2022 të datës 21.08.2024 ka ftuar paditësin A.B. që ta paguaj taksën gjyqësore.

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datës 26.08.2024, për heqjen dorë nga kërkesëpadia, e njofton gjykatën se heq dorë nga kërkesëpadia, pasi që me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtë gjyqësore.

Me nenin 3 par. 1 të LPK-së është paraparë se *“Palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat juridiko – civile që i kanë parashtruar gjatë procedurës”*, ndërsa me par.2 të këtij neni është paraparë se *“Palët mund të heqin dorë nga kërkesat e tyre, ta njohin kërkesën e palës kundërshtare si dhe të bëjnë pajtim gjyqësor lidhur me kontestin e tyre”*.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpadia nga ana e paditësit, konstatoi se kërkesat janë të disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 149, paragrafit 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së) – me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadiës apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)”* – pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Nga sa u tha më lartë, e bazuar në nenin 3 par. 1 dhe par. 2, lidhur me nenin 149 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.3390/2022, datë 02.09.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181, paragrafit 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se heqja dorë nga kërkesëpadia është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.